



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SHTIME



Npi – 01/129 datë: 19.06.2026

Për: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; Divizionin për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit,

Nga: Rrahman Jakupi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes,

Lënda: **KËRKESË PËR SQARIM SHITESË JURIDIK LIDHUR ME KËRKESËN E MAPL-së PËR ANULIMIN E MBLEDHJES SË DYTË TË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES**

Të nderuar,

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit, bashkëpunimit institucional dhe autonomisë lokale, në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, paraqes këtë kërkesë për sqarime shitesë juridike lidhur me shkresën e MAPL-së Nr. 020-282/12, datë 18.06.2026, përmes së cilës kërkohet anulimi i Mbledhjes së II-të të Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Shtimes.

I. KRONOLOGJIA E ÇËSHTJES

1. Më datë 12.05.2026, një e treta (1/3) e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Shtimes kanë parashtruar kërkesë për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme, së bashku me dokumentacionin përkatës.

Provë: Mbështjellësja e shkresave Nr. 01-070/05-9511/26, datë 12.05.2026.

2. Në përputhje me dispozitat ligjore dhe kërkesën e paraqitur nga anëtarët e Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit ka thirrur Mbledhjen e II-të të Jashtëzakonshme për datën 15.05.2026.

Provë: Ftesa Nr. Npi-01/88, datë 12.05.2026, dy shkresat e MAPL-së

3. Më datë 15.05.2026 është mbajtur Mbledhja e II-të e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Shtimes, në të cilën Kuvendi ka miratuar rendin e ditës dhe ka vendosur për pikat e propozuara.

Provë: Ekstrakti i Procesverbalit Nr. Npi-01/99, datë 15.05.2026.

4. Në këtë mbledhje janë miratuar, ndër të tjera:

- Vendimi për anulimin e Vendimit Nr. Npi-01/64, datë 02.04.2026, sipas rekomandimit të MAPL-së;
- Vendimi për anulimin e Vendimit Nr. Npi-01/65, datë 02.04.2026, sipas rekomandimit të MAPL-së;
- Vendimi për shfuqizimin e Vendimit Nr. Npi-01/17, datë 31.01.2011;
- Vendimi për formimin e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës së Kuvendit;
- Vendimi për formimin e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale;
- Vendimi për formimin e Komisionit për verifikimin e gjendjes së banesave publike komunale në objektin "Fitorja".

5. Më datë 18.06.2026, MAPL përmes shkresës Nr. 020-282/12 ka kërkuar anulimin e mbledhjes dhe të vendimeve të dala nga ajo, me arsyetimin se materialet për mbledhjen nuk u janë përcjellë anëtarëve të Kuvendit.

Provë: Shkresa ligjore e MAPL-së, nr. 020-282/12, datë: 18.06.2026

II. QËNDRIMI PARAPRAK I KUVENDIT LIDHUR ME KONSTATIMET E MAPL-SË

Pa paragjykuar shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes dhe duke respektuar kompetencat mbikëqyrëse të MAPL-së, konsideroj se konstatimet e paraqitura në shkresën Nr. 020-282/12, datë 18.06.2026, kërkojnë sqarime shtesë juridike, për shkak se ekzistojnë rrethana faktike dhe juridike të cilat nuk rezultojnë të jenë trajtuar në mënyrë të plotë.

Pretendimi se materialet nuk u janë përcjellë anëtarëve të Kuvendit nuk qëndron në mënyrë substanciale, duke pasur parasysh se:

- Pika 1 e rendit të ditës ka qenë e karakterit pyetje-përgjigje dhe nuk ka përbërë çështje vendimmarrëse që kërkon material paraprak.
- Për pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës, anëtarët e Kuvendit kanë qenë të pajisur me rekomandimet përkatëse të MAPL-së, si dhe me dokumentacionin e vendimeve që ishin objekt rishqyrtimi;
- Për pikën 4, në mbledhjen paraprake të rregullt të Kuvendit të mbajtur 02.04.2026, me kërkesën time si kryesues, anëtarët janë pajisur me kopje fizike të këtij Vendimi,
- për pikat 5 dhe 6, objekt shqyrtimi kanë qenë iniciimet e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e rregulloreve ekzistuese, ndërsa dokumentet bazë përkatëse kanë qenë dokumente publike, të cilat janë pranuar në mbledhjet paraprake përmes e-mail si dhe të qasshme në ueb-faqen zyrtare të Komunës;
- për pikën 7 është trajtuar propozimi për formimin e një komisioni verifikues me karakter organizativ, për të cilin nuk kërkohet dokumentacion, pasi që komisionet të tilla Kuvendi ka të drejtë t'i themelojë edhe Ad Hoc.

Rrjedhimisht, vlerësoj se qëllimi thelbësor i nenit 43 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale është përmbushur në substancë, pasi anëtarët e Kuvendit kanë pasur qasje reale dhe efektive në informacionin e nevojshëm për ushtrimin e mandatit dhe vendimmarrjes së tyre.

Andaj me sa vëreni se në mbledhjen e datës 15.05.2026:

- Nuk janë miratuar rregullore të reja;
- Nuk janë miratuar ndryshime përfundimtare normative;
- Nuk janë krijuar efekte të drejtpërdrejta juridike të përgjithshme për qytetarët.

Në këtë mbledhje janë trajtuar kryesisht:

- Rishqyrtime të vendimeve sipas rekomandimeve të MAPL-së;
- Shfuqizime të vendimeve ekzistuese;
- Inicime të procedurave për ndryshime dhe plotësime rregullative;
- Vendime organizative për formimin e komisioneve.

Për rrjedhojë, çdo pretendim për cenim të ligjshmërisë duhet të vlerësohet në raport me efektet juridike konkrete të akteve të miratuara dhe jo në mënyrë abstrakte apo të përgjithësuar.

Edhe në rast se hipotetikusht do të pranohej ekzistenca e ndonjë mangësie procedurale në shpërndarjen e materialeve, konsideroj se kërkesa për anulimin e tërësishëm të mbledhjes dhe të gjitha vendimeve të dala prej saj paraqet një masë joproporcionale në raport me natyrën e pretenduar të shkeljes.

Një qasje e tillë nuk merr parasysh:

- Natyrën e ndryshme të pikave të rendit të ditës;
- Dallimin ndërmjet akteve përfundimtare dhe akteve me karakter inicues ose organizativ;
- Mungesën e ndikimit të drejtpërdrejtë juridik të shumicës së vendimeve të miratuara.

Me këtë rast vlerësoj se kompetenca e MAPL-së për mbikëqyrjen e ligjshmërisë duhet të ushtrohet në raport me aktet konkrete juridike të nxjerra nga organet komunale dhe jo me anulimin e një mbledhjeje si ngjarje procedurale në tërësi, veçanërisht në rastet kur nuk rezulton se janë miratuar akte normative me efekte të përgjithshme juridike që cenojnë drejtpërdrejt ligjshmërinë materiale.

Bazuar në rrethanat e lartcekura, konsideroj se kërkesa për anulimin e mbledhjes së datës 15.05.2026 dhe të gjitha vendimeve të dala nga ajo mbledhje nuk rezulton të jetë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme në aspektin faktik, juridik dhe proporcional.

Për këtë arsye, para marrjes së një qëndrimi përfundimtar institucional, kërkoj sqarime shtesë juridike nga MAPL

III. ÇËSHTJET JURIDIKE QË KËRKOJNË SQARIM

1. Baza ligjore për kërkesën për anulimin e mbledhjes

Ju lutem të më sqaroni:

- Cila është dispozita konkrete ligjore që autorizon MAPL-në të kërkojë anulimin e një mbledhjeje të Kuvendit Komunal si tërësi?
- A konsideron MAPL se mbledhja e Kuvendit, si veprim procedural kolegjal, përbën akt juridik të veçantë që mund të jetë objekt anulimi?
- Cila është baza ligjore që do të mundësonte anulimin retroaktiv të një mbledhjeje tashmë të mbajtur?
- Cilat materiale konkrete konsideron MAPL se nuk u janë përcjellë anëtarëve të Kuvendit?
- Për cilat pika të rendit të ditës MAPL konsideron se mungesa e materialeve ka qenë relevante për vendimmarrjen?
- Në çfarë mënyre mungesa e pretenduar e materialeve ka ndikuar në mënyrë substanciale në procesin e vendimmarrjes?
- Cili është arsyetimi juridik mbi bazën e të cilit MAPL konsideron se anulimi i tërësishëm i mbledhjes dhe i të gjitha vendimeve të saj është masë proporcionale në raport me natyrën e shkeljes së konstatuar?


Duke qenë se çështjet e lartcekura janë me rëndësi thelbësore për shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës së MAPL-së dhe për vendimmarrjen e Kuvendit të Komunës së Shtimes, ju lutemi që sqarimet dhe qëndrimet tuaja juridike t'i përcillni me shkrim në afat sa më të arsyeshëm, në mënyrë që Kuvendi të mund të trajtojë çështjen në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi

MBËSHTJELLËSE E SHKRESAVE

Formulari nr. _____



LËNDA: Kerkesë për krijjen e mbledhjes së jashtëzakonshme
te Kuvendit të Komunes së Shtimes
Andarët e Kuvendit të Shtimes

Së bashku janë zgjidhë lëndët me numër : 9541126

Afati I ruajtjes: _____

Numri nga libri intern përcjellës _____

AFATI

1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16

Përpunoi

Vendi

Viti

Nënshkrimi i plotë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA SHTIME - OPŠTINA ŠTIMLJE - MUNICIPALITY OF ŠTIMLJE



Formulari për kerkese apo ankese

Drejtorati/Njesia

Kuvendi Komunal, Komitetet, Sherbimi Profesional i Kuvendit

Data 12/05/2026

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

ANETARET E KUVENDIT TE KOMUNES

Adresa e vendbanimit

SHTIME

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

400000000

2. Mënyra e pranimit

Statusi i lëndës

Kërkesa

Ne proces

Numri personal

0000000000

E-mail Adresa

Vlera për pagesë: 0.00

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

01-070/05-0009511/26

Afati i zgjedhjes

11/06/2026

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

KERKESE PER THIRJEN E MBLEDHJES SE JASHTEZAKONSHME TE KUVENDIT TE KOMUNES SE SHTIMES

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë ANETARET E KUVENDIT TE KOMUNES vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkonti nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: gonxhe.osmani



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SHTIME



Datë: 12.05.2026

PËR: **RRAHMAN JAKUPI, KRYESUES I KUVENDIT TË KOMUNËS,**
KOPJE: **QEMAJL ALIU, KRYETAR I KOMUNËS,**
NGA: **ANËTARËT E KUVENDIT TË KOMUNËS.**

LËNDA: **KËRKESË PËR THIRRJEN E MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME
TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES**

Në bazë të nenit 44 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/15), neneve 32, 33 dhe 37 paragrafi 37.2 të Statutit të Komunës së Shtimes Nr. 01 Nr. 06/1636, datë 03.09.2008, si dhe në përputhje me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, anëtarët e Kuvendit të Komunës së Shtimes, parashtrues dhe nënshkrues të kësaj shkrese, kërkojmë thirrjen e **Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Shtimes**, e propozuar të mbahet më **15 maj 2026 (e premte)**, në ora **10:00**, në sallën e **Kuvendit të Komunës së Shtimes**.

RENDI I DITES:

1. Pyetje dhe përgjigje,
2. Rishqyrtimi i Vendimit Nr. Npi-01/64, të datës 02.04.2026, sipas rekomandimit të Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-282/6, të datës 30.04.2026,
3. Rishqyrtimi i Vendimit Nr. Npi -01/65, të datës 02.04.2026, sipas rekomandimit të Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-410/3, të datës 08.05.2026,
4. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shfuqizimin e Vendimit të KK-së Nr. NPI-01-17, të datës 31.01.2011, për adresimin e kërkesave,
5. Shqyrtimi i propozimit për iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës së Kuvendit Nr. Npi -01-155, të datës 27.04.2023,
6. Shqyrtimi i propozimit për iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale për periudhë më pak se një (1) vit, Nr. Npi -01/459, të datës 27.12.2023,
7. Propozim - Vendim për formimin e Komisionit për verifikimin e gjendjes së pasurisë së banesave publike komunale në objektin "Fitorja" në Shtime.

ARSYETIM:

Thirrja e kësaj Mbledhjeje të Jashtëzakonshme është e domosdoshme për të siguruar funksionimin e rregullt, ligjor dhe kushtetues të Kuvendit të Komunës së Shtimes, për përmbushjen e obligimeve statutare dhe ligjore. Po ashtu, mbledhja është e nevojshme për, shqyrtimin e çështjeve me interes publik dhe urgjencë institucionale.

Në pajtim me legjislacionin në fuqi, kjo kërkesë mbështetet dhe nënshkruhet nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Shtimes, duke përmbushur kriterin ligjor për iniciimin e Mbledhjes së Jashtëzakonshme.

Anëtarët nënshkrues të Kuvendit të Komunës së Shtimes:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Nënshkrimi
1.	BAJRAM HAJRIZI	
2.	Fatlinda Rexhshi	
3.	Albana Podonice	
4.	Demokrat Mujeta	
5.	Amresha Sylta	
6.	FAIK RAMADANI	
7.	Erza Salija	
8.	Atdhe Isori	
9.	Frosinda Berisha Ahmeti	
10.		
11.		
12.		
13.		
14.		
15.		
16.		
17.		
18.		
19.		
20.		
21.		



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-32269/23 datë:15.12.2023



Npi – 01/459 datë: 27.12.2023

RREGULLORE

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË
SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT PRONËN E PALUAJTSHME
KOMUNALE

Dhjetor 2023



Npi – 01/459 datë: 27.12.2023

Duke u bazuar në kornizën ligjore si vijon: Neni 11 dhe 12, paragrafi 2, shkronja (c), lidhur me Nenin 17, paragrafi 1, shkoronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Nenin 6, paragrafi 1, pika 3 e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Nr.06/L-092 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2019); Nenin 7 të Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunes, Nr.09/2020; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës; Nenin 5 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636, të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, si dhe procesit të mbajtur të diskutimit publik me qytetarë, në seancën e rregullt të mbajtur më datën 27.12.2023, miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT PRONËN E PALUAJTSHME KOMUNALE

DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen, kriteret, kushtet dhe procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për interes publik, për periudhën kohore deri në një vit.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga organet e Komunës, personat fizik dhe juridik në territorin e Komunës së Shtimes.

Neni 3

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin, siç janë përkufizuar në Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Parimet e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës, bazohet në këto parime:
 - 1.1 **Parimi i Ligjshmerisë** - nënkupton se dhënia në shfrytëzim dhe këmbimi i pronës së paluajtshme të Komunës duhet të bazohet në Kushtetutë, ligj dhe akte tjera nënligjore.
 - 1.2 **Parimi i Efikasitetit** – nënkupton se organet e Komunës zhvillojnë procedurën për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, sa më shpejt dhe sa më pak shpenzime për Komunën dhe për palët, duke siguruar edhe qëllimin e dhënies së pronës për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal.
 - 1.3 **Parimi i Trajtimit të barabartë të palëve** – nënkupton se të gjitha palët në procesin e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, trajtohen në mënyrë të barabartë, duke shmangur çdo diskriminim ndaj palëve dhe duke vepruar në mënyrë objektive dhe të paanshme ndaj te gjithëve.
 - 1.4 **Parimi i Transparencës** – nënkupton se organet e Komunës duhet të veprojnë me transparencë, të respektojnë dhe të garantojnë të drejtat e palëve për t'u informuar lidhur me procedurat, kushtet dhe ecurinë e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.
 - 1.5 **Parimi i Ruajtjes dhe Rritjes së vlerës së Pronës publike të Komunës** – nënkupton se shfrytëzuesi i pronës Komunale është i detyruar që pronën ta shfrytëzoj në atë mënyrë që ta ruaj vlerën e saj dhe të përdore të gjitha masat përkatëse për rritjen e kësaj vlere.
 - 1.6 **Parimi i Ruajtjes së karakteristikave dhe vlerave unike të pronës** – nënkupton se shfrytëzuesi i pronës Komunale, duhet ta shfrytëzoj pronën vetëm sipas destinimit të pronës duke ruajtur vlerat e saj kulturore, historike, arkeologjike, arkitekturën historike dhe çdo vlerë tjetër unike të saj, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës deri në një vit

1. Komunitat mund të japin në shfrytëzim pronën e paluajtshme të Komunës për më pak se 1 (një) vit.
2. Pronat e paluajtshme të cilat mund të jepen në shfrytëzim për më pak se 1 (një) vit, janë:
 - 2.1 Objektet dhe hapësirat publike në pronësi të Komunës, të listuara si në vijim:
 - 2.1.1 Hapësirat Publike (parqet, sheshet, bulevardet, panot reklamuese, kioskat deri në 6 m²),
 - 2.1.2 Shtëpitë e kulturës, kinematë, teatrot, dhe terrenet rekreative-sportive,
 - 2.1.3 Hapësirat publike para lokaleve,
 - 2.1.4 Pronat në pronësi të Komunës,

- 2.1.5 Hapësirat publike rreth vend punishteve,
- 2.2 Kompensimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një (1) vit përcaktohet me Rregullore të Komunës për Taksa, Tarifa dhe Gjoha.

Neni 6

Kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës

1. Prona e paluajtshme e Komunës jepet në shfrytëzim për periudhën më pak se 1 (një) vit, duke u bazuar në kriteret vijuese:
 - 1.1 Të jetë e rexhistruar si pronë e Komunës në rexhistrat kadastral të pronës.
 - 1.2 Të jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta,
 - 1.3 Të mos ketë ndonjë kontest pronësor,
 - 1.4 Të plotësoj kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore,
 - 1.5 Të ketë arsyeshmeri të interesit publik,
 - 1.6 Të ndikoj në rritjen e zhvillimit ekonomik në Komunë,
 - 1.7 Të ndikoj në rritjen e vlerave të diversitetit arsimor, kulturo-sportiv e të ngjashme.

Neni 7

Procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për periudhën më pak se 1 (një) vit

1. Prona e paluajtshme e Komunës jepet në shfrytëzim për periudhën më pak se 1 (një) vit për personat fizik dhe juridik të cilët shprehin interesim përmes kërkesës zyrtare me shkrim.
2. Kërkesa duhet t'i drejtohet organit kompetent, përkatësisht Komisionit të formuar me vendim të Kryetarit të Komunës.
3. Prona e paluajtshme e cila jepet në shfrytëzim mbi bazën e kërkesës së shqyrtuar të aplikuesit, duhet të shfrytëzohet vetëm për destinimin e caktuar.

Neni 8

Kushtet për Aplikim

1. Personat fizik dhe juridik me rastin e aplikimit për të marrë në shfrytëzim pronën e paluajtshme të Komunës duhet të bashkëngjeshin këto dokumente:
 - 1.1. Formularin e plotësuar me të dhënat e kërkuara,
 - 1.2. Kopja e letërnjoftimit për personat fizik përfaqësues,
 - 1.3. Çertifikata e regjistrimit të biznesit për personat juridik,
 - 1.4. Historiati i biznesit, konkretisht dëshminë për kryerjen e obligimeve ndaj ATK-se për personat juridik (nuk vlen për bizneset fillestare),
 - 1.5. Veprimtaria që do të zhvillojë,
 - 1.6. Projekti ideor,
 - 1.7. Vërtetimi nga Komuna për përmbushjen e obligimeve të tatimit në pronë dhe

taksave komunale (nuk vlen për biznese fillestare).

2. Në rastet kur dokumentacioni nuk është i kompletuar, Komisioni Vlerësues kërkon plotësimin e tij nga parashtruesi i kërkesës. Nëse edhe brenda afatit të caktuar nga Komisioni nuk plotësohet dokumentacioni i kërkuar, kërkesa do të refuzohet.

Neni 9

1. Për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim deri në një vit, Komuna zbaton dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Komisioni i themeluar për vlerësimin e kërkesave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme deri në një vit është përgjegjës për marrjen e vendimit të dhënies/mosdhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim deri në afatin një vjeçar.
3. Sipas kësaj rregulloreje, në lidhje me paragrafin 2 të këtij neni, nuk është e nevojshme që vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim deri në një vit të miratohet në Kuvendin e Komunës së Shtimes.

Neni 10

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës për Organizata te shoqërisë civile

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së Komunës për organizata të shoqërisë civile, për periudhën për më pak se një (1) vit, jepet me procedura të njëjta siç është përcaktuar me këtë rregullore.
2. Dhënia në shfrytëzim e pronës së Komunës për organizata te shoqërisë civile jepet nga një (1) ditë deri në dhjetë (10) ditë të cilat kanë për qëllim ushtrimin e veprimtarive në kuadër të kompetencave vetanake të komunës, për promovimin e vlerave kulturore, historike, arkeologjike, sportive, rinore, e të ngjashme.
3. Organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë për qëllim ushtrimin e aktiviteteve të cekura në paragrafin 2 të këtij Neni, prona e paluajtshme iu jepet në shfrytëzim vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga Komisioni.
4. Organizatat e shoqërisë civile të cilat ushtrojnë veprimtarinë apo aktivitetet rehabilituese për personat me nevoja të veçanta, prona e paluajtshme e Komunës mund të u jepet në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit, vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga Komisioni.

Neni 11

Formimi dhe përbërja e Komisionit Vlerësues

1. Kryetari i Komunës nxjerr Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues i cili në bazë të kësaj rregulloreje ka kompetencë dhe autoritet të jap rekomandime për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
2. Komisioni do të ketë përbërje prej tre (3) anëtarëve ku Kryesuesi i komisionit duhet të jetë një zyrtar nga drejtoria përkatëse së cilës i është drejtuar kërkesa për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, ndërsa 2 anëtar duhet të jenë nga drejtoritë tjera të fushave adekuate profesionale.

3. Njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë jurist. Përveç anëtareve të rregullt të komisionit, Kryetari i Komunës duhet të parasheh edhe një 1 (një) anëtar rezervë, i cili do të zëvendësoj në rast nevojë anëtarin e Komisionit Vlerësues.
4. Komisioni shqyrton kërkesën në afat prej pesëmbëdhjetë (15) dite pune, nga dita e parashtrimit të kërkesës, dhe konstaton gjendjen faktike në teren, nëse është në harmoni dhe përputhshmeri me arsyeshmerinë e kërkesës.
5. Pas shqyrtimit të kërkesës, komisioni përgatit raport përfundimtar dhe i rekomandon Kryetarit të Komunës për nënshkrimin e kontratës me palën e përzgjedhur.
6. Mandati i komisionit do të jete 2 (dy) vite.

Neni 12

E drejta e ankesës

1. Pala e pakënaqur kundër procesit të vlerësimit të kërkesës, ka të drejtë të parashtojë ankesë në komisionin për ankesa të Komunës, në afat prej 7 (shtatë) dite pune nga dita e pranimi të vendimit.
2. Komisioni është i obliguar që ankesën e palës ta shqyrtoj brenda afatit prej 7 (shtatë) dite pune nga dita e pranimi të ankesës.
3. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave.
4. Përberja e komisionit duhet të jetë prej 5 (pesë) anëtarëve, ku njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë jurist, ndërsa të tjerët profesionist.
5. Vendimi i Komisionit të ankesave për miratimin ose refuzimin e ankesës së palës është përfundimtar në procedurën administrative në Komunë.
6. Pala e pakënaqur me vendimin e komisionit të ankesave brenda afatit ligjor prej tridhjetë ditësh (30) nga dita e marrjes së vendimit, mund të iniciojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.
7. Komisioni për shqyrtimin e ankesave do të jetë me mandat për 2 (dy) vite.

Neni 13

Konflikti i Interesit

1. Anëtarët e Komisionit përjashtohen nga procesi vendimarrjes nëse ai/ajo ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
2. Anëtarët e Komisionit vlerësues përjashtohen nga procesi vlerësues nëse ai/ajo ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
3. Anëtarët e Komisionit për shqyrtimin e ankesave përjashtohen nga procesi i shqyrtimit të ankesave nëse ai/ajo ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 14

Nënshkrimi i Kontratës

1. Bazuar në rekomandimin e komisionit vlerësues dhe pas kalimit të afatit të procedurave të ankesës, Kryetari i Komunës nënshkruan kontratën me të përzgjedhurin, me të cilën kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese.
2. E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se 1 (një) vit, nuk mund të bartet te personat e tretë.

DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 14

Mbikqyrja e Kontratës

1. Kryetari i Komunës ka të drejtën për nxjerrjen e vendimit për formimin e komisionit mbikëqyrës për të bërë mbikëqyrjen e realizimit të kontratës nga ana e palës kontraktuese, sipas kushteve të kontratës.
2. Në rast të mos respektimit të kontratës, apo shmangies nga qëllimi për të cilin prona është marrë në shfrytëzim sipas kërkesës së palës, komisioni mbikëqyrës paraqet raport përfundimtar me të cilin do t'i rekomandoj Kryetarit të Komunës për shkëputje të njëanshme të kontratës.
3. Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të raportit përfundimtar, të përgatitur nga komisioni mbikëqyrës dhe duke u bazuar në rekomandimin e dhënë, do ta shkëpus kontratën në mënyrë të njëanshme, duke e njoftuar palën kontraktuese, 7 (shtatë) ditë para ndërprerjes së kontratës.
4. Komuna është e obliguar që të publikoj listën e pronave të cilat i kanë dhënë në shfrytëzim për periudhën më pak se 1 (një) vit sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
5. Komuna obligohet që të bëjë publikimin e listës së pronave të paluajtshme të Komunës të dhëna në shfrytëzim në faqen zyrtare të Komunës së Shtimes brenda 7 (shtatë) ditëve, nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Neni 15

Mirëmbajtja e Pronës së Komunës

1. Te gjithë shfrytëzuesit e pronës komunale, janë të detyruar që t'i mirembajnë dhe t'i shfrytëzojnë në mënyrën e caktuar konform kontratës për marrje në shfrytëzim.
2. Personat fizik dhe juridik dhe të gjithë shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme të Komunës, janë të detyruar të kujdesën për mbrojtjen e pronës së paluajtshme, ashtu siç parashihet me këtë Rregullore.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE

Neni 16

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen Rregulloret dhe Vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Shtimes të cilat bien ndesh me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 17

Konflikti me Ligjin

Ne rast konflikti dhe mospërputhje të dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, do të aplikohen dispozitat e Ligjit dhe akteve të tjera nënligjore që janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 18

Zbatimi i Rregullores

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje obligohen Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë Komunale kompetente.

Neni 19

Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Shtimes dhe pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës së Shtimes.



KRYESUESI I KUVENDIT

Adnan Ademi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-9920/23 datë: 19.04.2023



Npi – 01/155 datë: 27.04.2023

RREGULLORE

E PUNËS SË KUVENDIT DHE KOMITETEVE

Prill 2023

Duke u bazuar në nenin 12.2.b. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008); Rregulloren e (MAPL) Nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës; Udhëzimin Administrativ të MAPL-së për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës Nr.02/2015; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 datë 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 27.04.2023, miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR PUNËN E KUVENDIT DHE KOMITETEVE

I. Dispozitat e përgjithshme

Qëllimi

Neni 1

Me këtë Rregullore, rregullohet udhëheqja dhe funksionimi i punës së Kuvendit dhe Komiteteve, duke përfshirë edhe kontrollin efikas financiar të Administratës Komunale.

Përkufizimi

Neni 2

Përkufizimet në këtë Rregullore: Përkufizimet e termave janë të rregulluara me nenin 3 të Ligjit Për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040 të Republikës së Kosovës.

Përgjegjësitë e Kuvendit

Neni 3

Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- 3.1 Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- 3.2 Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- 3.3 Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregulloreve të punës;
- 3.4 Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- 3.5 Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij Ligji;
- 3.6 Zgjedhjen e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Komunës;
- 3.7 Niveli i tarifave dhe ngarkesave;
- 3.8 Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- 3.9 Emërimin dhe rrimërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- 3.10 Arritjen e marrëveshjeve ndër komunale dhe brenda komunale;
- 3.11 Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- 3.12 Përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

II. Mbajtja e mbledhjeve të Kuvendit dhe të Komiteteve

Mbledhjet dhe kuorumi

Neni 4

- 4.1 Bazuar në Udhëzimin Administrativ të (MAPL) Nr.02/2015, Kuvendi mbanë: 1. Mbledhje Inauguruese, 2. Mbledhje të Rregullta, 3. Mbledhje të Jashtëzakonshme, 4. Mbledhje Urgjente, dhe 5. Mbledhje Solemne.
- 4.2 Kuvendi i Komunës dhe Komitetet e tij mbajnë mbledhjet e tyre në orar të rregullt, ashtu siç është përcaktuar me nenin 43.2 të Ligjit Për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040 të Republikës së Kosovës, dhe Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636, datë 03.09.2008.
- 4.3 Kryesuesi i Kuvendit duhet të thërrasë dhe të kryesojë mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Kryesuesit e Komiteteve duhet t'i thërrasin dhe t'i kryesojnë mbledhjet e Komiteteve përkatëse.
- 4.4 Në mungesë të Kryesuesit, kryesimi i mbledhjes bëhet nga anëtari më i moshuar i Kuvendit-Komitetit, i pranishëm në mbledhje.
- 4.5 Kuvendi, Komitetet dhe Trupat tjerë të Kuvendit mund të organizojnë mbledhje nga distanca (on-line) në kushte të pa parashikuara (Vis Major)
- 4.6 Për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të njoftohen paraprakisht me E-mail ashtu siç kërkohet, me nenin 5.3 të Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr.02/2015, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet: Data e mbajtjes së mbledhjes; Koha e mbajtjes së mbledhjes; Vendi i mbajtjes së mbledhjes; Rendi i ditës për mbledhje; Materialet e mbledhjes; Të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.
- 4.7 Anëtarët e Komiteteve duhet të njoftohen për mbledhje me E-mail, së paku, tri ditë pune më parë. Njoftimi për mbledhjet e Komiteteve përfshin: Data e mbajtjes së mbledhjes; Koha e mbajtjes së mbledhjes; Vendi i mbajtjes së mbledhjes; Rendi i ditës për mbledhje; Materialet e mbledhjes; Të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.
- 4.8 Komitetet obligohen që planin vjetor të punës së tyre, si dhe pikat e rendit të ditës për mbledhje, parimisht t'i harmonizojnë me planin e punës dhe rendin e ditës të mbledhjeve të Kuvendit.
- 4.9 Takimet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës mund të thirren duke u bazuar në nenin 44 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 të Republikës së Kosovës, dhe nenit 6 të Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr.02/2015,
- 4.10 Sipas nenit 7 të Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr.02/2015, Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës kanë të drejtë të thërrasin mbledhje urgjente të Kuvendit të Komunës në rast të fatkeqësive natyrore dhe rrethanave të tjera në komunë. Procedurat për thirrjen e mbledhjeve urgjente, nuk zbatohen si në rastet e thirrjes së mbledhjeve tjera të Kuvendit të Komunës.

- 4.11 Njoftimi publik për mbledhje duhet të shpallet në të njëjtën kohë në Ueb-faqen e Komunës si dhe në mjetet e informimit publik, duke u bazuar në “Udhëzimin Administrativ të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Nr.04/2018 për Transparencë në Komuna”.
- 4.12 Kryesuesi duhet të sigurohet se janë përmbushur kushtet për pikat e neneve 4.6, 4.7, 4.8 dhe 4.9 për mbajtjen e të gjitha mbledhjeve të Kuvendit dhe Komiteteve.
- 4.13 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve duhet të mbahet procesverbal në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Nr.02-L-37, dhe nëse ekzistojnë kushtet teknike, edhe incizimi elektronik, në mënyrë që të ketë mundësi që stenogrami t’u dërgohet anëtarëve të Kuvendit. Procesverbali duhet të përmbajë emrat e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në mbledhje dhe të anëtarëve të ftuar, rendin e ditës, çështjet, të cilat do të diskutohen, rezultatin numerik të votimit dhe propozimet e miratuara, apo të refuzuara. Nëse kërkohet të thirret emri i secilit këshilltar, në procesverbal duhet shënuar si ka votuar secili. Procesverbalin e mban një shërbyes civil komunal i emëruar. Procesverbali duhet të miratohet në mbledhjen e ardhshme. Secili anëtar ka të drejtë ta shikojë procesverbalin dhe ta marrë një kopje.
- 4.14 Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve përbëhet nga një më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
- 4.15 Secili anëtar që merr pjesë në mbledhje duhet të shënojë emrin e tij në listën e pjesëmarrësve, ose në listën për personat e pranishëm, të paraparë për këtë qëllim. Lista e prezencës të anëtarëve të Kuvendit-Komitetit në mbledhje, dorëzohet për nënshkrim në fund të mbledhjes.
- 4.16 Subjekti i cili ka numër më të madh të anëtarëve të Kuvendit e ka të drejtën me zgjedhë rendin e ulëseve, ndërsa subjektet tjera radhiten në ulëse sipas numrit të votave të fituara.
- 4.17 Anëtarët e Kuvendit duhen të pajisen me kartela identifikuese, të cilat obligohen t’i vendosin në një vend të dukshëm dhe barten gjatë mbledhjes.
- 4.18 Subjekti Politik i përfaqësuar në Kuvend të Komunës e zgjedhë përfaqësuesin e vetë të subjektit politik përkatës dhe e bën të ditur në mbledhjen e parë Inauguruese.

Pjesëmarrja e publikut në mbledhje

Neni 5

- 5.1 Përveç të drejtës së dhënë sipas Ligjit dhe Statutit të Komunës, pjesëmarrësit nga publiku mund t’i jepet fjala nga Kryesuesi në mbledhje për çështje të caktuara të rëndësisë publike.
- 5.2 Kryesuesi i mbledhjes duhet të kujdeset që diskutimi i tij/sajë të mos zgjatë më shumë se tre minuta, t’i përmbahet pikës të rendit të ditës që shqyrtohet, si dhe të mos ketë përsëritje të diskutimit, për të cilat Kryesuesi ka të drejtë ta ndërpresë.
- 5.3 Pjesëtarëve të publikut që marrin pjesë në mbledhje duhet të ju kërkohet paraqitja e rastit/rasteve të konfliktit të interesit dhe nëse ka konflikt interesi, Kryesuesi nuk duhet t’i lejoj që të marrin pjesë në mbledhje kur shqyrtohet rasti i tyre.

5.4 Kuvendi i Komunës apo Komiteti me shumicën e votave mund të vendosë për përjashtimin e opinionit nga i tërë ose një pjesë e mbledhjes, duke u bazuar në nenin 45.3 pikat (a) deri (d), të LVL-së Nr.03/L-040.

Rendi i ditës dhe renditja e punëve

Neni 6

- 6.1 Propozimin e Rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit, Komitetit, e përgatit Kryesuesi në marrëveshje me Kryetarin e Komunës.
- 6.2 Asnjë nga pikat e propozuara të rendit të ditës nuk do të shtrohen për diskutim në mbledhje pa miratimin e Kuvendit, përveç në rastet (urgjente), të cilat do të konstatohen në procesverbalin e Kuvendit, Komitetit, si çështje urgjente me rëndësi publike.
- 6.3 Rendi i ditës në mbledhje të Kuvendit-Komitetit, zakonisht është ky:
- 6.3.1 Konstatimi i pjesëmarrjes në mbledhje të anëtarëve të Kuvendit-Komitetit (Kuorumi), pjesëmarrja e publikut dhe ekzekutivit të Komunës,
 - 6.3.2 Shqyrtimi (miratimi ose mosmiratimi) i procesverbalit të mbledhjes së fundit, Shqyrtimi i peticioneve,
 - 6.3.3 Punët që kryhen në mbledhje, të cilat parashihen në bazë të Rregullores, Statutit, ose ligjeve në fuqi,
 - 6.3.4 Çfarëdo çështje e shtruar nga Kryesuesi i mbledhjes dhe temat që shtrohen aty, ose cilado punë e papërfunduar nga mbledhja e fundit,
 - 6.3.5 Raportet dhe rekomandimet e marra nga Komitetet dhe të gjitha çështjet e tjera që lindin si rezultat i raporteve,
 - 6.3.6 Propozimet dhe rekomandimet e drejtuara nga drejtoritë që vijnë nga Kryetari,
 - 6.3.7 Çështjet që kanë të bëjnë me aktivitete të Komunës dhe të shtruara nga anëtarët, sipas rendit, ashtu si janë pranuar ato,
 - 6.3.8 Propozimet e shtruara nga anëtarët, sipas radhës së pranimi të tyre,
 - 6.3.9 Kërkesat e ndryshme për Kuvendin, përkatësisht Komitetet,
 - 6.3.10 Pika të ndryshme, që sipas mendimit të Kryesuesit, meritojnë të shqyrtohen në mbledhje.
- 6.4 Në mbledhje mund të vendoset që të punohet me rendin e ndryshuar të ditës.
- 6.5 Nuk mund të diskutohet asnjë pikë e rendit të ditës, para se të aprovohet si propozim për diskutim në mbledhje.
- 6.6 Kur bëhen propozime për rendin e ditës, Kryesuesi i evidenton propozimet sipas renditjes atyre që e kanë marrë fjalën, ndërkaq në votim të parin e hedh Rendin e Ditës që ka ardhur me ftesën për mbledhje si propozim i Kryesuesit në bashkëpunim me Kryetarin, kështu që me aprovimin e propozimit të parë, propozimet e tjera nuk hedhen në votim.
- 6.7 Anëtar i Kuvendit të Komunës mund të kërkojë shtimin e një pike të rendit të ditës para miratimit të rendit të ditës, në seancën e rregullt të Kuvendit të Komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike.
- 6.8 Pasi Kryesuesi i Kuvendit/Komitetit ka përgatitur rendin e ditës, Shërbimi Profesional i Kuvendit, në bashkëpunim me Drejtorinë për Administratë duhet:

- 6.8.1 T'i dërgojë secilit anëtar të Kuvendit materialin, i cili përmban shënime lidhur me çështjet, të cilat do të shtrohen në mbledhje, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë elektronike,
- 6.8.2 T'i njoftojë anëtarët e Kuvendit-Komitetit se materiali është i gatshëm për tërheqje dhe mund ta bëjnë gjatë orëve të rregullta të punës në zyrën e Shërbimit për punët e Kuvendit.
- 6.9 Kërkesat e palëve që paraqiten te zyra pritëse, duhet fillimisht të adresohen te Ekzekutivi i Komunës përkatësisht te Drejtoria Kompetente, dhe pastaj nëse Drejtoria e konstaton se kërkesa duhet të adresohet në Kuvend ajo e transferon Kërkesën e palës në zyrën e Kuvendit së bashku me rekomandimin e sajë.

Rregullat e diskutimit

Neni 7

- 7.1 Kryesuesi i Kuvendit është i obliguar të respektoj parimin e të drejtës së barabartë për diskutim dhe pjesëmarrje aktive të anëtarëve në punën e Kuvendit.
- 7.2 Nëse dy ose më shumë anëtarë dëshirojnë të marrin fjalën, Kryesuesi i mbledhjes vendos për renditjen e diskutimeve. Anëtarët i drejtohen Kryesuesit të mbledhjes dhe gjatë diskutimit të tyre duhet t'u përmbahen çështjeve aktuale të mbledhjes. Gjatë diskutimeve përparësi u jepet përfaqësuesve të subjekteve politike. Për renditjen e përfaqësuesve të subjekteve politike që kanë kërkuar fjalën, vendoset sipas numrit më të madh të anëtarëve që kanë subjektet politike në Kuvend.
- 7.3 Anëtarët mund të kërkojnë të flasin sipas renditjes, ose sipas shpjegimeve personale, dhe diskutimet e tyre do të dëgjohen. Vendimi i Kryesuesit për renditjen, ose për pranueshmërinë e shpjegimeve, është vendimtar.
- 7.4 Kur një propozim i dhënë është duke u diskutuar, nuk lejohet dhënia e propozimeve të tjera, përveç:
- 7.4.1 Ndryshimit të Propozimit;
 - 7.4.2 Propozimit për të parandaluar çrregullimet;
 - 7.4.3 Propozimit për të përjashtuar publikun dhe mjetet e informimit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 7.4 të Rregullores;
 - 7.4.4 Propozimit për të kaluar në pikën me radhë të rendit të ditës;
 - 7.4.5 Propozimit, i cili kërkon që çështja në diskutim të mbyllet në mbledhje me marrjen e vendimit;
 - 7.4.6 Propozimit për të shtyrë diskutimin e çështjes së shtruar për mbledhjen e ardhshme;
 - 7.4.7 Propozimit për ndërprerjen e mbledhjes.
- 7.5 Kryesuesi në mbledhje nuk do të lejojë asnjë propozim, derisa të gjithë ata që dëshirojnë të diskutojnë për Propozimin e dhënë ta kenë bërë këtë për kohë të mjaftueshme, përveç nëse tërhiqen nga diskutimet e tyre.
- 7.6 Kur ndonjë anëtar e ka fjalën në mbledhje, të gjithë anëtarët e tjerë pjesëmarrës qëndrojnë ulur, të mbajnë qetësinë, dhe të kufizojnë përdorimin e telefonit.
- 7.7 Nëse ndonjë anëtar jep ndonjë propozim, ai ka të drejtë të marrë përgjigje nga zyrtarët kompetentë të drejtorisë përkatëse, menjëherë para se propozimi t'i nënshtrohet votimit.
- Gjatë tërë kohëzgjatjes së mbledhjes, Kryesuesi duhet të respektojë parimin që të gjithë anëtarët pjesëmarrës dhe me të drejtë diskutimi, të gëzojnë të drejtën e barabartë dhe të kenë rastin që të marrin pjesë aktivisht në mbledhje.

- 7.8 Përfaqësuesit e Subjekteve Politike në Kuvend, kanë në dispozicion 5 (pesë) minuta për një diskutim, me të drejtë sqarimi edhe për 3 (tre) minuta shtesë, në diskutimin e dytë, brenda të njëjtës pike, ndërsa për çështje që konsiderohen të rëndësishme, vendoset nga Kuvendi.
- 7.9 Anëtarët e Kuvendit kanë në dispozicion 5 (pesë) minuta për një diskutim brenda të njëjtës pike.
- 7.10 Sqarimet plotësuese apo diskutimi për here te dytë, në kuadër te një pike të rendit të ditës, lejohet vetëm pas përfundimit të gjithë te paraqiturve për diskutim dhe atë në kohëzgjatje deri në 3 (tre) minuta.
- 7.11 Nëse gjatë diskutimit nga ndonjë anëtar i Kuvendit i përmendet emri anëtarit tjetër, ai ka të drejtë në replikë jo më gjatë se dy minuta.
- 7.12 Kur ndonjë anëtar diskuton në mbledhje, ai duhet të jetë i qartë dhe i përgatitur dhe të mos i lejohet që të tejkalojë minutat e përcaktuar në nenin 7.9 dhe 7.10 të kësaj Rregulloreje.
- 7.13 Diskutimet e Ekzekutivit lidhur me informatat nuk votohen dhe nuk duhet të jenë më të gjata se 5 minuta.
- 7.14 Raportet nga Ekzekutivi, të cilat votohen nuk duhen të jenë më të gjata se 10 minuta. Për çështjet e tjera me rëndësi, vendos Kuvendi.
- 7.15 Për pyetjet e ngritura për pikat e rendit të ditës, Ekzekutivi ka në dispozicion, për secilën pyetje, një minutë, që të japë përgjigje me gojë, me përjashtim të pikës së rendit të ditës (Pyetje- Përgjigje), ku përgjigjet mund të merren me shkrim ose me gojë.
- 7.16 Anëtarët e Kuvendit pyetjet mund ti paraqesin me gojë ose me shkrim.

Votimi

Neni 8

- 8.1 Votimi në të gjitha mbledhjet bëhet me ngritjen e dorës, ose në formë elektronike, nëse Kuvendi vendos që votimi të bëhet në mënyrë të fshehtë, ose kur aktet më të larta kanë paraparë mënyrë tjetër të votimit.
- 8.2 Para votimit, secili anëtar ka të drejtë të kërkojë që rezultatet e votimit të regjistrohen, ku do të shihen emrat e të gjithë anëtarëve që kanë votuar dhe emrat e atyre që abstenojnë.
- 8.3 Secili anëtar mund të kërkojë që në procesverbalin e mbledhjes të shënohet se si ai ka votuar për çështjen e caktuar, ose nëse ai ka abstenuar.
- 8.4 Kur ka nevojë të bëhet votimi i propozimit për emërimin ose zgjedhjen e ndonjë anëtari për pozitën, e cila duhet të mbulohet edhe nga Komuna dhe kur ekzistojnë dy ose më shumë kandidatë të propozuar për pozitën në fjalë, emrat e të gjithë të propozuarve paraqiten në mbledhje në formë të shkruar, sipas ranglistës së panelit intervistues, ose sipas radhë alfabetike të emrave të tyre.
- 8.5 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, Komiteteve, secili anëtar ka nga një votë. Në rast të numrit të njëjtë të votave, Kryesuesi ka një votë shtesë, që mund ta përdorë “Për” ose “Kundër” ndonjë propozim, sipas nenit 48.1 të LVL – Nr.03/L-040.

- 8.6 Vendimet e Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve të tij merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm, të cilët votojnë, përveç nëse me Ligj, Statut ose Rregullore është paraparë ndryshe.
- 8.7 Abstenimet regjistrohen me qëllim të konstatimit të kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.
- 8.8 Përgatitjet e fletëvotimeve, kutive të votimit si dhe ruajtja e materialit për së paku 1(një) vit bëhet nga Drejtoria për Administratë, në bashkëpunim me shërbimin e Kuvendit.
- 8.9 Para fillimit të procesit të votimit të fshehtë, Kuvendi zgjedhë Komisionin Votues, i cili udhëheq me procesin e votimit, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.
- 8.10 Propozimi, apo zgjedhja votohet menjëherë duke shënuar shenjat (X), (V) si dhe shenjë e rumbullakimit (O) afër numrit rendor të kandidatit të preferuar dhe duke e hedhur votën në kutinë e votimit.
- 8.11 Rezultatet e votimit shpallen menjëherë pas numërimit të votave nga Komisioni Votues.
- 8.12 E drejta e pjesëmarrjes dhe e votimit u merret të gjithë delegatëve, të cilët kanë konflikt e interesi për pikën e caktuar, sikurse në votimin e hapur, ashtu edhe votimin e fshehur.

Kodi i mirësjelljes

Neni 9

- 9.1 Nëse Kryesuesi i mbledhjes konsideron se ndonjëri prej anëtarëve nuk sillet mirë në mbledhje, duke mos respektuar kërkesat e Kryesuesit, duke e penguar me dashje punën e mbledhjes, ose duke u sjellë në mënyrë ofenduese, atij duhet t'i tërhiqet vërejtja. Nëse sjelljet e anëtarit në fjalë vazhdojnë të jenë të pandryshueshme, Kryesuesi i mbledhjes mund të ndërmarrë njërën prej këtyre masave, veçmas, ose si varg masash:
 - 9.1.1 Anëtarit të Kuvendit i ndalohej diskutimi i mëtutjeshëm në mbledhje,
 - 9.1.2 E udhëzon anëtarin e Kuvendit, Komitetit, të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga pjesa e mbetur e mbledhjes, përveç kur do të ketë votime,
 - 9.1.3 Jep urdhrin që anëtari të largohet nga mbledhja, përveç kur do të ketë votime,
 - 9.1.4 E shtyn mbledhjen për një orë ose deri në kohën apo datën që caktohet.
- 9.2 Nëse pjesëmarrësi në mbledhje nga publiku me dashje i ndërpret punët e mbledhjes, Kryesuesi i mbledhjes do t'ia tërheqë vërejtjen atij për mbajtjen e qetësisë. Nëse ai vazhdon të ndërhyjë në mbledhje, Kryesuesi i mbledhjes mund të ndërmarrë njërën prej këtyre masave, veçmas, ose si varg masash:
 - 9.2.1 E udhëzon pjesëmarrësin të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga mbledhja,
 - 9.2.2 Jep urdhrin që pjesëmarrësi të largohet nga mbledhja,
 - 9.2.3 E shtyn mbledhjen për një orë, ose deri në kohën, apo datën që caktohet.
- 9.3 Nëse mbledhja ndërpritet për ndonjë çrregullim më të madh, Kryesuesi i mbledhjes mund të urdhërojë që të gjithë ta lirojnë sallën e mbledhjes dhe mund ta shtyjë mbledhjen për një orë, ose deri në kohën, apo datën që caktohet.

III. Procedura e ndryshimit

Neni 10

Procedura e ndryshimit të Rregullores së punës së Kuvendit-Komiteteve duhet të jetë:

10.1 Iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës së Kuvendit, mund ta ndërmarrë 1/3 e Anëtarëve të Kuvendit, si dhe Kryesuesi i Kuvendit,

10.2 Çdo propozim për ndryshimin e Rregullores së punës shqyrtohet nga Komiteti për Politikë dhe Financa, i cili duhet të dalë me rekomandime.

IV. Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Neni 11

11.1 Në rastet e konfliktit të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale ose Statutin e Komunës, vlejnë dispozitat e aktit më të lartë.


11.2 Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e mëparshme e Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 datë: 26.4.2019.

11.3 Rregullorja hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

REFERENCE:	Nr.
DATË:	28.04.2026
PËR/ZA/TO:	Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës së Shtimes Rrahmaj, Jakupi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes
PËRMES/PREKO/THROUGH	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshme në MAPL Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së
CC	
NGA/OD/FROM:	Drin Haraçia, Drejtor i Departamentit për Mbikëqyrje dhe Performanc Lokale Kujtim Aliu, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Legjislacionit Lokal Kushtrim Osmani, Zyrtar i Lart për Monitorim të Legjislacionit Lokal
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shkresë ligjore

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka monitoruar mbledhjen e rregullt të kuvendit të komunës së Shtimes, të mbajtur me datë: 02.04.2026. Gjatë monitorimit të mbledhjes MAPL ka konstatuar se rendi i ditës nuk u miratua dhe si pasojë e kësaj kryesuesi i kuvendit të komunës së Shtimes ke hedhur për herën e dytë në votim rendin e ditës me dy pikat e propozuara nga një anëtar i kuvendit, ku më pastaj u miratua rendi i ditës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në kompetencat dhe mandatin ligjor të përcaktuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregullorja (QRK) - Nr.04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, konstaton se:

- Nga analiza e dokumentacionit përkatës dhe e zhvillimit të mbledhjes rezulton se, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të mbajtur më 02.04.2026, Kryesuesi i Kuvendit e ka hedhur në votim rendin e ditës, i cili ka rezultuar me 7 (shtatë) vota për, 12 (dymbëdhjetë) vota kundër dhe 0 (zero) abstenime, duke konstatuar se i njëjti nuk është miratuar. Më pas, rendi i ditës është hedhur sërish në votim, i plotësuar me ndryshime, dhe është konstatuar se me shumicë votash është miratuar.

- Bazuar në nenin 47, paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, anëtari i Kuvendit të Komunës ka të drejtë të propozojë shtimin e një pike në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt, nëse çështja e propozuar është urgjente dhe me rëndësi publike. Kërkesa e tillë mund të miratohet apo refuzohet me votën e shumicës.

Në këtë drejtim, konstatohet se nuk është respektuar dispozita e nenit 47, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe neni 6.7 i Rregullores së Punës së Kuvendit Komunal, sipas të cilave një anëtar i kuvendit mund të propozojë shtimin e një pike në rendin e ditës para miratimit të tij vetëm në rastet kur çështja është urgjente dhe me rëndësi të veçantë publike.

Njëkohësisht, nuk është respektuar as neni 47, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, i cili përcakton se kërkesa për përfshirjen e një pike në rendin e ditës duhet të miratohet ose të refuzohet paraprakisht, përpara miratimit të rendit të ditës në tërësi.

Mosrespektimi i këtyre dispozitave procedurale përbën shkelje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe të Rregullores së brendshme të komunës.

Në këtë kontekst, vlerësohet se vendimet e miratuara mbi bazën e pikave të rendit të ditës të shtuara në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore nuk përmbushin standardet e kërkuara të ligjshmërisë procedurale dhe, si të tilla, cenojnë vlefshmërinë e tyre juridike.

Bazuar në sa më sipër, MAPL kërkon nga organet e Komunës së Shtimes që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për anulimin e vendimeve në fjalë: "Propozim-vendim shfuqizimi i vendimit të kuvendit nr. NPI-01/17, date 31.01.2011 dhe "Propozim- Vendim për ndryshimin e nenit 6.9 të rregullores së punës së kuvendit" dhe të sigurojnë që aktet e miratuara në kundërshtim me procedurat ligjore të mos zbatohen, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

MAPL mbetet e gatshme të ofrojë mbështetje profesionale me qëllim të sigurimit të zbatimit të plotë dhe të drejtë të legjislacionit për vetëqeverisjen lokale.

Me respekt,

PËR: MINISTRIN E ADMINISTRIMIT TË RUSHTETIT LOKAL (MAPL)

KUNDËR: MBLEDHJES E RREGULLT TË KUVENDIT KOMUNAL TË SHTIMES TË DATËS 7 PRILL
2026.


NGA: LËVIZIA VETEVENDOSJEI

DATA: 15 PRILL 2026

KËRKESË PËR ANULIMIN E MBLEDHJES E RREGULLT TË KUVENDIT KOMUNAL TË SHTIMES TË
DATËS 2 PRILL 2026 DHE VENDIMEVE TË MIRATUARA

Parashtresit e kërkesës

LËVIZIA VETEVENDOSJEI



15.04.2026

I. HYRJE

1. Kërkesa bazohet në nenin 80, 81 dhe 82 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Ligji për Vetëqeverisjen Lokale") dhe nenin 6 të Rregullores [NpL-01/155] së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve ("Rregullorja e punës") dhe Statutin [Nr.01-06/1636] e Komunës së Shtimes ("Statut").
2. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë anulimin e Mbledhjes së II të rregullt të Kuvendit Komunal të Shtimes të mbajtur më datën 2 prill 2026 dhe vendimeve të miratuara në atë mbledhje.
3. Kërkesa parashtrohet brenda afatit ligjor për shqyrtimin e ligjshmërisë nga MAPL-ja, në kuptim të nenit 80.1 dhe 80.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

II. FAKTET E RASTIT

4. Më 24 mars 2026, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Shtimes bëri ftesë për mbledhjen e II të rregullt të Kuvendit Komunal të Shtimes, së bashku me rendin e ditës, si në vijim:
 - Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 05.03.2026;
 - Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2026;
 - Formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa;
 - Emërtimi i anëtarëve të Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës;
 - Pasqyrat Financiare për vitin 2025;
 - Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve nga Kuvendi të Komisionit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/26;
 - Informatë për Planin e Punës të Drejtorisë së Prokurimit;
 - Pyetje Përgjigje.

5. Më 2 prill 2026, Kuvendi Komunal i Shtimes mbajti mbledhjen e rregullt.

6. Në këtë mbledhje, anëtari nga Partia Demokratike e Kosovës propozoi ndryshimin e rendit të ditës, respektivisht shtimin e dy pikave të reja të rendit të ditës: (i) shfuqizimin e Vendimit [Np-01/17] të datës 31.01.2021 të Kuvendit Komunal të Shtimes; (ii) ndryshimin e nenit 6.9 të Rregullores së punës të Kuvendit dhe Komiteteve [Np-01/155] të datës 27.04.2023. Anëtari nga Lidhja Demokratike e Kosovës kërkoj ndryshimin e rendit të ditës, respektivisht: (i) shtyrjen e pikës së pestë për Pasqyrat Financiare për vitin 2025.

7. Kryesuesi i Kuvendit Komunal e hodhi në votim rendin e ditës: 7 votuan pro, 12 kundër

8. Kryesuesi i Kuvendit Komunal e hodhi në votim rendin e ditës, me ndryshimet e propozuara nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja e Demokratike e Kosovës: 12 votuan për, 7 kundër. Me shumicë votash u aprovua rendi i ditës me ndryshime.

9. Më 2 prill 2026, Kuvendi Komunal i Shtimes mbajti mbledhjen e rregullt, me rendin e ndryshuar të ditës, ku miratoi gjithsej 8 (tete) vendime.

10. Më 7 prill 2026, Kuvendi Komunal i Shtimes vendimet e miratuara në mbledhje i përcolli për shqyrtim të ligjshmërisë në MAPL.

III. PRETENDIMET E KËRKESËS

11. Neni 6.7 i Rregullores së punës përcakton si në vijim:

"Anëtari i Kuvendit të Komunës mund të kërkojë shtimin e një pike të rendit të ditës para miratimit të rendit të ditës, në seancën e rregullt të Kuvendit të Komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike."

12. Dispozita e lartcekur parashet të drejtën e anëtarit të Kuvendit Komunal të propozojë ndryshimin e rendit të ditës. Anëtari i Kuvendit Komunal: (i) mund të kërkojë shtimin e vetëm një pike të rendit të ditës; dhe (ii) çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente dhe me rëndësi publike. Pra duhet përmbushur të dy kushtet e lartcekura për tu ndryshuar rendi i ditës.

(i) *Anëtari i Kuvendit të Komunës mund të kërkojë shtimin e një pike të rendit të ditës*

13. Në rastin konkret, Kryesuesi i Kuvendit Komunal kishte bërë ftesë për mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal të Shtimes, për datën 02.04.2026, në ora 10:00. Në këtë ftesë ishte përcaktuar edhe rendi i ditës me 8 pika. Megjithatë, në fillim të mbledhjes, anëtari nga radhët e PDK-së kërkoi shtimin e dy pikave të veçanta të rendit të ditës, të cilat u hodhën në votim dhe me shumicë votash u aprovuan nga Kuvendi Komunal.
14. Një gjë e tillë ishte në kundërshtim me nenin 6.7 të Rregullores së punës, e cila përcakton që anëtari i Kuvendit Komunal ka të drejtë të kërkojë shtimin e vetëm një pike të rendit të ditës. Dispozita ligjore e përdorë fjalën në njëjes dhe jo shumës, pra vetëm një pikë të rendit të ditës dhe jo disa pika të rendit të ditës. Kjo është logjika e kësaj dispozite ligjore, që nuk lejon ndryshimin e konsiderueshëm të rendit të ditës.
15. Neni 4.6 i Rregullores së punës përcakton që Kryesuesi i Kuvendit Komunal duhet të njoftojë të gjithë anëtarët e Kuvendit, shtatë ditë para mbledhjes, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit. Ky njoftim ndër të tjera përfshin edhe njoftimin mbi rendin e ditës. Edhe neni 6.8 i Rregullores së punës e obligon Shërbimin Profesional të Kuvendit që t'ia dërgojë secilit anëtar të Kuvendit materialin lidhur me çështjet të cilat do të shtrihen në mbledhje.
16. Siç shihet nga këto dispozita ligjore, përcaktimi i rendit të ditës është i rëndësishëm, sepse ua mundëson anëtarëve të Kuvendit Komunal të jenë të njoftuar me materialin dhe të kenë mundësi të jenë të përgatitur për diskutimet e çështjeve të rendit të ditës. Ndryshimi i më shumë pikave të rendit të ditës në mbledhjen e rregullt, e vështirëson punën e anëtarëve të Kuvendit Komunal, duke i vendosur në një situatë ku ata nuk janë të përgatitur për diskutimin e atyre pikave. Për këtë arsye, neni 6.7 i Rregullores së punës e kufizon mundësinë e propozimit të pikave shtesë të rendit të ditës.
17. Në përfundim, dy propozimet për shtimin e pikave të reja të rendit të ditës në mbledhjen e rregullt të datës 2 prill 2026, ishin në kundërshtim me nenin 6.7 të Rregullores së punës, në lidhje me nenin 4.6 dhe 6.4 të Rregullores së punës.
- (II) nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente dhe me rëndësi publike*

18. Neni 6.7 i Rregullores kërkon që propozimi për shtimin e një pike të rendit të ditës mund të bëhet vetëm nëse çështja është urgjente me rëndësi publike. Pra, kjo dispozitë e ngushton hapësirën për shtimin e pikave të rendit të ditës, vetëm në raste të caktuara të cilat janë urgjente dhe me rëndësi publike. Rrjedhimisht, çështjet të cilat nuk janë urgjente duhet të përcaktohen paraprakisht si pika të rendit të ditës, në mënyrë të rregullt, ku të gjithë anëtarët e Kuvendit njoftohen dhe përgatiten me materialet e nevojshme.
19. Në rastin konkret, propozimet për shtimin e pikave të rendit të ditës kishin të bënin me shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit Komunal të Shtimes të vitit 2011; si dhe ndryshimin e nenit 6.9 të Rregullores së punës.
20. Që të dyja këto propozime për shtimin e pikave të rendit të ditës, nuk ishin aspak çështje urgjente në kuptim të neni 6.7 të Rregullores së punës. Këto dy çështje mund të propozoheshin si pika të rendit të ditës në çfarëdo mbledhje tjetër të rregullt të Kuvendit Komunal. Në këtë mënyrë, anëtarët e Kuvendit do të ishin të njoftuar paraprakisht, do të përgatiteshin me materialet e nevojshme dhe do të diskutonin dhe vendosnin për ato çështje.
21. Kryesuesi i Kuvendit Komunal dhe anëtarë që i propozoi këto dy pika shtesë të rendit të ditës, nuk ofruan asnjë argument dhe arsye në lidhje me urgjencën e këtyre dy pikave të rendit të ditës, por vetëm i propozuan dhe hodhën në votim.
22. Si përfundim, propozimi i dy pikave të reja të rendit të ditës ishte në kundërshtim me nenin 6.7 të Rregullores së punës, sepse nuk ishin çështje urgjente me rëndësi publike.

Përfundim

Bazuar në të gjitha argumentet e lartcekura, kërkojmë nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, që pas vlerësimit të ligjshmërisë, të nxjerrë:


VENDIM

- I. Shpallet e paligjshme Mbledhja e II e rregullt e Kuvendit Komunal të Shtimes e mbajtur më datën 2 prill 2026.
- II. Anulohen të gjitha vendimet e miratuara në mbledhjen e lartcekur.

Parashtruar me respekt

Shtime, më 15 prill 2026

LËVIZJA VETËVENDOSJEI





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës së Shtimes Rrahman Jakupi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes	
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Nga:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Datë: 17.04.2026 -VI-020-282
Zyrtarët përgjegjës:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL	
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Komunë	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit	
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Diturie Bekteshi, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve Komunale	
Lënda:	Shkresë përcjellëse	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 8, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, marrë parasysh se ky vendim nuk bënë pjesë të vendimet e përgjithshme të kuvendit të komunës vlerëson se:

- *Vendimi Npi-01/64 për shfuqizimin e vendimit të KK Npi-01/17 dt.31.01.2011 për adresimin e kërkesave të qytetarëve, nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë.*

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHITES
Nr.01-060/01-6158/26 datë:24.03.2026

Npi - 01/64 datë: 02.04.2026



Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Kuvendi i Komunës së Shites në mbledhjen e mbajtur më: 02.04.2026, miratoi:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT Npi-01/17 TË DATËS 31.01.2011

I

Kuvendi i Komunës së Shites, në mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më: 02.04.2026, unanimisht miratoi, Vendimin për Shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shites, Npi-01/17 të datës 31.01.2011, për Adresimin e Kërkesave të Qytetarëve.

II

Vendimi hynë në fuqi 30 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokolli zyrtar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Drejtorive, MAPL-së, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/122, Datë: 20.01.2011



Npi - 01/17, Datë: 31.01.2011

Në bazë të nenit 12,2.d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe Statutit të Komunës, Kuvendi Komunal-Shtime në seancën e parë të rregullt për vitin 2011, të mbajtur më datën: 31.01.2011. shqyrtoi rekomandimin e Komitetit për Politik dhe Financa dhe mori këtë:

V E N D I M

PËR ADRESIMIN E KËRKESAVE TË QYTETARËVE

I

Kuvendi Komunal-Shtime në mbledhjen e parë të rregullt për vitin 2011, të mbajtur më datën: 31.01.2011, unanimisht ka vendosur që kërkesat e qytetarëve që kanë të bëjnë me mjete Financiare të adresohen te Ekzekutivi i Komunës, përkatësisht në Drejtorit kompetente.

II

Në qoftëse sipas ligjit për e një kërkesë nevojitet edhe aprovimi i Kuvendit, Ekzekutivi kërkon zyrtarisht shqyrtimin e kërkesës në Kuvend.

III

Vendimi është marrë duke u bazuar në rekomandimin e Komitetit për Politik dhe Financa

IV

Vendimi dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit, MAPL-së,



Kryesuesi i Kuvendit
Kujtim Xhelili



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës së Shtimes	
Kopje:	Rahman Jakupi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Nga:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Data: 05.05.2026 -VI-0-410/2
Zyrtarët përgjegjës:	Erbilin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL	
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Komunë	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit	
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Diturie Bekteshi, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve Komunale	
Lënda:	Shkresë përcjellëse	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 8, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe duke u bazuar në raportin e monitorimit të mbledhjes së II-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Shtimes, ku konstatohet se vendimet e miratuara mbi bazën e pikave të rendit të ditës të shtuara janë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore nuk përmbushin standardet e kërkuara të ligjshmërisë procedurale dhe, si të tilla, cenojnë vlefshmërinë e tyre juridike.

Bazuar nga sa u tha më sipër, "Vendimi Npi-01/65 për ndryshimin e nenit 6.9 të rregullores së punës të Kuvendit dhe Komiteteve Npi-01/155 të datës 27.04.2023", është miratuara në kundërshtim me procedurat ligjore si dhe me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, andaj nuk i nënshtrohet shqyrtimit të ligjshmërisë.

Andaj, bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Shtimes duhet të ndërmer veprime dhe brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme në lidhje me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHITIME
Nr.01-060/01-6158/25 datë:24.03.2026



08.04.2026

01-0-440/2

Npi - 01/65 datë: 02.04.2026

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Kuvendi i Komunës së Shitimes në mbledhjen e mbajtur më: 02.04.2026, miratoi:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN E NENIT 6.9 TË RREGULLORES TË PUNËS SË KUVENDIT DHE KOMITETEVE Npi-01/155 TË DATËS 27.04.2023

I

Kuvendi i Komunës së Shitimes, në mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më: 02.04.2026, unanimitisht miratoi, Vendimin për ndryshimin e Nenit 6.9 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/155 të datës 27.04.2023, Nga formulimi ekzistues në Rregullore si vijon: "Kërkesat e palëve që paraqiten te zyra pritëse, duhet fillimisht të adresohen të Ekzekutivi i Komunës përkatësisht te Drejtoria Kompetente, dhe pastaj nëse Drejtoria e konstaton se kërkesa duhet të adresohet në Kuvend ajo e transferon Kërkesën e palës në zyrën e Kuvendit së bashku me rekomandimin e sajë." Në formulimin e ri si vijon: "Kërkesat e palëve dorëzohen në Arkivin e Komunës, i cili bënë pranimin, evidentimin dhe shpërndarjen e tyre sipas adresimit të bërë nga pala. Zyrtari përgjegjës i Arkivit, pas pranimit dhe regjistrimit të kërkesës, e përçejll atë drejtpërdrejt te organi kompetent, përfshirë Kuvendin e Komunës apo drejtoritë përkatëse, në përputhje me përmbajtjen dhe adresimin e kërkesës, pa qenë e nevojshme që kërkesa të kalojë paraprakisht nëpërmjet Ekzekutivit të Komunës."

II

Vendimi hynë në fuqi 30 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Drejtorive, MAPL-së, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi



REPUBLIKA KOSOVA
SKUPŠTINA OPŠTINE-ŠTIMLJE
Br.01-060/01-6158/26 datum: 24.03.2026



Bip - 01/65 datum: 02.04.2026

Na osnovu člana 12.2 tačke (d) Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03/L-040. („Službeni glasnik Republike Kosovo“ br. 28/2008); Skupština opštine Stimlje, na sednici održanoj: 02.04.2026. godine, usvojila je:

ODLUKA

O IZMENI ČLANA 6.9 PRAVILNIKA SKUPŠTINE I ODBORA Bip-01/155 OD DATUMA 27.04.2023.

I
Skupština Opštine Stimlje, na drugoj redovnoj sednici za 2026. godinu, održanoj: 02.04.2026. godine, jednoglasno je usvojila Odluku o Izmeni člana 6.9 Pravilnika Skupštine i Odbora, Bip-01/155 od 27.04.2023. godine,

Iz postojeće formulacije u Pravilniku, kako sledi: „Zahtevi stranaka koji se podnose kancelariji za prijem moraju se prvobitno uputiti Izvršnoj vlasti opštine, odnosno nadležnoj direkciji, a zatim, ako Direkcija utvrdi da zahtev treba uputiti Skupštini, prosleđuje zahtev stranke kancelariji Skupštine zajedno sa svojom preporukom.“

U novoj formulaciji glasi: „Zahtevi stranaka se podnose Opštinskom Arhivu, koji ih prima, evidentira i distribuira prema adresi koju je stranka navela.

Nadležni službenik arhive, nakon što primi i registruje zahtev, prosleđuje ga direktno nadležnom organu, uključujući Skupštinu Opštine ili nadležne direkcije, u skladu sa sadržajem i adresom zahteva, bez potrebe da zahtev prethodno prođe kroz Opštinski Izvršni Organ.“

II


Odluka stupa na snagu 30 dana od dana registracije u zvaničnoj evidenciji protokola u Ministarstvu za Lokalnu Samoupravu.

III

Odluka se dostavlja: Arhivi, Predsedavajućem Skupštine, Gradonačelniku, Direkcijama, MLSA i Kancelariji za Informisanje.



Predsedavajući Skupštine
Rrahman Jakupi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

REFERENCE:	Nr.
DATE:	28.04.2026
PËR/ZA/TO:	Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës së Shtimes Rrahmaj, Jakupi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes
PËRMES/PREKO/THROUGH	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së
CC	
NGA/OD/FROM:	Drin Haraçia, Drejtor i Departamentit për Mbikëqyrje dhe Përformanc Lokale Kujtim Aliu, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Legjislacionit Lokal Kushtrim Osmani, Zyrtar i Lart për Monitorim të Legjislacionit Lokal
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shkresë ligjore

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka monitoruar mbledhjen e rregullt të kuvendit të komunës së Shtimes, të mbajtur me datë: 02.04.2026. Gjatë monitorimit të mbledhjes MAPL ka konstatuar se rendi i ditës nuk u miratua dhe si pasojë e kësaj kryesuesi i kuvendit të komunës së Shtimes ke hedhur për herën e dytë në votim rendin e ditës me dy pikat e propozuara nga një anëtar i kuvendit, ku më pastaj u miratua rendi i ditës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në kompetencat dhe mandatin ligjor të përcaktuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregullorja (QRK) - Nr.04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, konstaton se:

- Nga analiza e dokumentacionit përkatës dhe e zhvillimit të mbledhjes rezulton se, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të mbajtur më 02.04.2026, Kryesuesi i Kuvendit e ka hedhur në votim rendin e ditës, i cili ka rezultuar me 7 (shtatë) vota për, 12 (dymbëdhjetë) vota kundër dhe 0 (zero) abstenime, duke konstatuar se i njëjti nuk është miratuar. Më pas, rendi i ditës është hedhur sërish në votim, i plotësuar me ndryshime, dhe është konstatuar se me shumicë votash është miratuar.

- Bazuar në nenin 47, paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, anëtar i Kuvendit të Komunës ka të drejtë të propozojë shtimin e një pike në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt, nëse çështja e propozuar është urgjente dhe me rëndësi publike. Kërkesa e tillë mund të miratohet apo refuzohet me votën e shumicës.

Në këtë drejtim, konstatohet se nuk është respektuar dispozita e nenit 47, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe neni 6.7 i Rregullores së Punës së Kuvendit Komunal, sipas të cilave një anëtar i kuvendit mund të propozojë shtimin e një pike në rendin e ditës para miratimit të tij vetëm në rastet kur çështja është urgjente dhe me rëndësi të veçantë publike.

Njëkohësisht, nuk është respektuar as neni 47, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, i cili përcakton se kërkesa për përfshirjen e një pike në rendin e ditës duhet të miratohet ose të refuzohet paraprakisht, përpara miratimit të rendit të ditës në tërësi.

Mosrespektimi i këtyre dispozitave procedurale përbën shkelje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe të Rregullores së brendshme të komunës.

Në këtë kontekst, vlerësohet se vendimet e miratuara mbi bazën e pikave të rendit të ditës të shtuara në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore nuk përmbushin standardet e kërkuara të ligjshmërisë procedurale dhe, si të tilla, cenojnë vlefshmërinë e tyre juridike.

Bazuar në sa më sipër, MAPL kërkon nga organet e Komunës së Shtimes që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për anulimin e vendimeve në fjalë: "Propozim-vendim shfuqizimi i vendimit të kuvendit nr. NPI-01/17, date 31.01.2011 dhe "Propozim- Vendim për ndryshimin e nenit 6.9 të rregullores së punës së kuvendit" dhe të sigurojnë që aktet e miratuara në kundërshtim me procedurat ligjore të mos zbatohen, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

MAPL mbetet e gatshme të ofrojë mbështetje profesionale me qëllim të sigurimit të zbatimit të plotë dhe të drejtë të legjislacionit për vetëqeverisjen lokale.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-9511/26 datë:12.05.2026



Npi – 01/88 datë: 12.05.2026

Duke u bazuar në nenin 44, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Nenet 37, të Statutit të Komunës së Shtimes Nr.01Nr.06/1636 datë 03.09.2008; Si dhe në bazë të nenit 4 paragrafi 9 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Kryesuesi i Kuvendit bazuar në Kërkesën e 1/3 të anëtarëve të Kuvendit (9 anëtarë) për thirrjen e mbledhjes së Jashtëzakonshme të Kuvendit për datën 15.05.2026, vendosi të bëjë këtë:

F T E S Ë

PËR MBLEDHJEN E -II- TË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES

MBLEDHJA DO TE MBAHET NË SALLËN E KUVENDIT

Më datën: 15.05.2026, Dita e Premte

Në ora: 10.ººAM.

Për këtë mbledhje propozojmë këtë:

R E N D D I T E

1. Pyetje – Përgjigje,
2. Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/64 të datës 02.04.2026, sipas rekomandimit të MAPL-së Nr.020-282/6 të datës 30.04.2026,
3. Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/65 të datës 02.04.2026, sipas rekomandimit të MAPL-së Nr. 020-410/3 të datës 08.05.2026,
4. Shqyrtimi i Propozim - Vendimit për shfuqizimin e Vendimit Npi-01/17, të datës 31.01.2011 për adresimin e kërkesave,
5. Shqyrtimi i propozimit për iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës së Kuvendit Npi-01/155, të datës 27.04.2023,
6. Shqyrtimi i propozimit për iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale për periudhë më pak se një (1) vit, Npi-01/459 të datës 27.12.2023,
7. Propozim – Vendim për formimin e Komisionit për verifikimin e gjendjes së pasurisë së banesave publike komunale në objektin “Fitorja” në Shtime.



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi



Npi – 01/99 datë: 15.05.2026

Duke u bazuar në nenin 44 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për vazhdimin e mbledhjes së Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Shtimes e mbajtur më 15.05.2026, është nxjerrë:

E K S T R A K T **P R O C E S V E R B A L**

I Mbledhjes së -II- të Jashtëzakonshme për vitin 2026, të Kuvendit të Komunës së Shtimes, e mbajtur më datën 15.05.2026 (e premte), në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e jashtëzakonshme e hapi Kryesuesi i Kuvendit z.Rrahman Jakupi.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Rrahman Jakupi, Antarët e Kuvendit: z.Grejtalb Emini, z.Besnik Seferi, z.Zenel Shabani, z.Artan Lubovci, z.Faruk Beqa, znj.Uskana Deliu, znj.Adelina Shabani, znj.Albana Ramadani, z.Demokrat Mujota, z.Faik Ramadani, znj.Albana Podvorica, znj.Fatlinda Rrafshi, znj.Arbresha Sylja, z.Bajram Hajrizi, z.Haqif Arifi, znj.Frosina Berisha-Ahmeti, znj.Erza Salija, z.Atdhe Isufi, z.Muhamet Ademaj. Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe Nënkryetari, z.Adnan Ademi; DPUKGJ, z.Bardhyl Rushiti; DSHMS, znj.Mimoza Salihu-Qeriqi; DPP, z.Valon Januzi; DSHP, z.Halil Kurtishi; DZHE, z.Grejtalb Emini; Zyrtare, znj.Vlora Hyseni; Zyrtarë i IT-së, z.Shpëtim Gashi; Praktikantët, z.Albion Shabani, znj.Hava Llugaxhija, znj.Agnesa Ademaj, znj.Admire Selmani dhe znj.Teuta Mustafa.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi e njoftoi Kuvendin me rendin e ditës të propozuar si vijon:

REND DITE

1. Pyetje – Përgjigje,
2. Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/64 të datës 02.04.2026, sipas rekomandimit të MAPL-së Nr.020-282/6 të datës 30.04.2026,
3. Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/65 të datës 02.04.2026, sipas rekomandimit të MAPL-së Nr. 020-410/3 të datës 08.05.2026,
4. Shqyrtimi i Propozim - Vendimit për shfuqizimin e Vendimit Npi-01/17, të datës 31.01.2011 për adresimin e kërkesave,
5. Shqyrtimi i propozimit për iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës së Kuvendit Npi-01/155, të datës 27.04.2023,
6. Shqyrtimi i propozimit për iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale për periudhë më pak se një (1) vit, Npi-01/459 të datës 27.12.2023,
7. Propozim – Vendim për formimin e Komisionit për verifikimin e gjendjes së pasurisë së banesave publike komunale në objektin “Fitorja” në Shtime.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Përsëritet. Fillimisht para se me e vazhdu diskutimin për rendin e ditës e ftojme znj.Albana Ramadani që të jap Betimin si anëtare e re e Kuvendit.

znj.Albana Ramadani: Unë, Albana Ramadani, betohem se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltare e Kuvendit të Komunës së Shtimes, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë. Betohem!

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Po ashtu me lejoni para se të fillojë me mbledhjen që në emër timin personal të ju uroj kandidatëve për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga gjitha subjektet politike, mirëpo meqë e kemi këtu kolegen znj.Frosina Berisha-Ahmeti ta gëzoj dhe ta uroj për kandidaturën, pastaj dhe mikun tim nga, LVV-ja z.Naim Rexhaj, pastaj edhe kolegun dhe mikun tim nga AAK-ja z.Ramë Bislimin, si dhe fqinjën tim z.Ergjan Mehmetaj nga Komunitetet. Meqë jemi në prag të fushatës zgjedhore uroj të jetë një fushatë e qetë dhe qytetarët e Shtimes dhe gjithë Republikës së Kosovës të vendosin për kandidatët me të mirë kështu që suksese për gjithë këta kolegë. Në vazhdim konstatoj kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje, ndërsa mungon z.Shefqet Krasniqi për arsye shëndetsore. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale neni 44 përkatesisht paragrafi 44.3 ky rend i ditës nuk mundë të ndryshoj prandaj sa për formalitet ju ftojë ta votojm dhe të vazhdojm me pikat e rendit të ditës ashtu siç kanë paraparë 1/3 e anëtarëve të Kuvendit për ta thirrë këtë mbledhje.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Fillimish ne si grup i asamblesës komunale të LVV-së, mendojm që kjo seancë e jashtëzakonshme nuk ka asgjë të jashtëzakonshme në rendin e ditës për cilin e keni thirrur ju PDK-ja dhe LDK-ja. Nuk mbaj mend dhe nuk besoj që në bazë të gjithë përvojës sime që më ka përcjell gjatë gjithë këtyre viteve që ndonjëherë ka ndodhë që në një seancë të jashtëzakonshme të përfshihet si pikë e rendit ditës pika Pyetje-Përgjigje. Kjo vetëm dëshmon se nuk është asgjë urgjente përveq një skenar politik e elektorral. PDK dhe LDK qenkan bërë bashkë për fat të keq edhe kësaj here, ashtu siç kanë qenë që nga Shtatori i 2025, ku fillimish nuk u votua Buxheti më i madhë që ka pas ndonjëherë Komuna e Shtimes e më pas deri në ditën e fundit u bë zvarritja e miratimit të tij, duke mbajtur peng projektet dhe nevojat e qytetarëve të Komunës së Shtimes. Pastaj në një nga seancat e para nën arrogancat e votës kuptohet ndaj të pagat, medijtjet, për njerzit tuaj duke dëmtuar drejtpërdrejt Buxhetin e Komunës së Shtimes, dhe duke cunuar projektet e ndërtuar mbi kërkesat e tyre, dhe bordet e kompanive publike i ndaj të sipas interesave tuaja partiake. Sot në këtë seancë që është krejtësisht në efekt elektorral zgjedhor na keni mbledhur për disa tema që po i quani të jashtëzakonshme e ndër to edhe ndryshimin e rregullores për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim për më pak se një vit. Por mbajeni mend se këto rregullore që po tentoni të i ndryshoni, i keni miratuar vetë unanimisht në vitin 2023 atëherë ju është dukur e mirë, ndërsa sot papritmas po i ndryshoni. Prandaj ne si grup parlamentar i LVV-së por besoj edhe ekzekutivi në përgjithësi, detyrohemi që këtë seancë të jashtëzakonshme ta lëshojmë në ora 10:30h, për arsye të mospërputhjes së ligjshmërisë që ka kjo seancë.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Konstatoj Kuorumin prej 11 anëtarve prezent. Fjalën ja dha z.Demokrat Mujota.

z.Demokrat Mujota: Përshëndetje. Duhet me kuptu mirë se urgjenca e kësaj mbledhje janë kërkesat e qytetarëve, kthimi nga MAPL-ja i disa vendimeve tona ku fillimisht janë kthyer që janë mirë, tani ndikimi i tyre ka bërë që pas disa ditëve me e kthyer edhe një vendim tjetër që nuk është mirë por ne kemi vendosur që në mënyrë urgjente me u mbledhë për dy arsye. Arsyeja e parë me e shkarku mbledhjen e rregullt sepse po bëhen shumë pika, arsyeja e dytë është kërkesat e qytetarëve pyetjet që i kemi pas ne në drejtim të ekzekutivit komunal, për banesa të "Fitorja", për pasurin që nuk dihet kujt po ja japim për çka po i japim se çfarë vendime po ja japin. Mirëpo tu ik prej përgjegjësis nuk mundesh me punu për qytetarët, mirëpo duke mbajtur përgjegjësi jep mesazh se këta që i kanë marrë votat prej qytetarëve janë njerzit e duhur.

znj.Arbresha Sylja: Përshëndetje. Realisht partia e VV-së e liruan sallën padrejtësisht dhe në mënyrë jo profesionale, e liruan edhe drejtorët mirëpo kisha përshtypjen se drejtorët do të rrinë këtu dhe do të ju përgjigjen gjithë qytetarëve, në këtë rast opozitës si përfaqësues të qytetarëve të Komunës së Shtimes. Sot takimi është pikërisht për kërkesat e tyre, me ndryshimet e Ligjit medijtje nuk ka sot dhe nuk keqpërdoret Buxheti Komunal. Mbledhja e jashtëzakonshme nuk është thirrur për medijtje por përkundrazi është thirrur për disa kërkesa dhe disa urgjenca në kuptimin edhe formal edhe juridik që jemi obliguar.

z.Haqif Arifi: Përshëndetje. Mbledhja nuk është thirrur me asnjë qëllim, nuk është thirrur me bërë asnjë përmbysje thjeshtë është thirrur për me e krye ni obligim që qytetari na ka besu. Ato që i

lexoj kolegu, Besnik Seferi unë nuk munda me i kuptu se asnjë prej atyre ne si opozitë nuk kemi mundur me i bë. Ato nëse janë bë janë prej pushtetit aktual, këtë më së miri e dëshmoj sepse Vetëvendosja e filloj fushatën në vendin ku nuk i takoj kështu që është për keqardhje së pari për ta po edhe për qytetarët në këtë rast le të shohin kush është duke penguar, e kush është duke u munduar për të mirën e qytetarit. Kemi pas disa rekomandime nga MAPL-ja ato u dashtë me i shqyrtu, mos me i lënë me i tubu të gjitha pikat në rendin e ditës sepse kur po ka pika shumë edhe po ngarkohemi. Megjithatë këta duhet me ditë me dallu urgjente prej emergjente, sepse nuk kemi të bëjmë diqka me fatëkeqsi po kemi të bëjmë me aspektin administrativ.

znj.Erza Salija: Përshendetje. Fatkeqësisht u dëshmuar edhe njëherë papërgjegjshmëria e ekzekutivit, kërkesat edhe pyetjet në interes të qytetarëve nuk po gjejnë përgjigje. Të gjitha pikat e parapara në këtë rend të ditës janë në interes të qytetarëve, mirëpo kështu kanë vendos me shërby anëtarët e Vetëvendosjes, vetëm hedhin akuza të pavërteta e pastaj nuk janë në gjendje me u përballë as me realitetin e as me replika.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Meqë nuk ka diskutime tjera, po e hedh në votim rendin e ditës ashtu siç ka ardhur nga 1/3 e anëtarëve të Kuvendit. Konstatoj Kuorumin prej 11 anëtarve prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Pyetje – Përgjigje

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Unë kam shumë pyetje për ekzekutivin, mirëpo ashtu siç e përmendët edhe ju nuk është hera e parë që anëtarët e VV-së po e lirojnë sallën. Po shihet se kush po dëshiron me e blloku Kuvendin e Komunës. Nuk ka ma urgjenc se sa kërkesat e qytetarëve të Shtimes, ne paguhemi me mjete financiare, me rroga të rregullta mujore, për të diskutuar për çështje për të cilat jemi votuar nga qytetarët.

znj.Albana Podvorica - Hoxha: Përshëndetje. Unë propozoj që pika pyetje - përgjigje me mbetet për mbledhjen e ardhshme, për arsye që drejtorat nuk janë prezent edhe ashtu nuk është që në shumicën e rasteve na kthejnë përgjigje me email, kështu që propozoj që këtë pikë me lënë për mbledhjen e ardhshme dhe të marrim përgjigje.

znj.Frosina Berisha – Ahmeti : Përshëndetje. Pa dyshim që të gjitha çështjet e ngritura janë në interesin e qytetarëve dhe mbrenda kompetencave të parapara me ligj. Asambleistat dhe ekzekutivi i LVV-së po krijojnë një praktikë jo të mirë në Kuvend. Pasi vetëm mbajnë deklarata dhe na mbajnë leksione se si duhet të bëjmë punën tonë për të cilën jemi zgjedhur direkt nga qytetarët, dhe pastaj nuk presin të marrin përgjigje nga ne. Pasi nuk e kemi këtu prezent ekzekutivin nuk kemi dhe nga kush të marrim përgjigje por vetëm kisha pas dëshirë me ja rikujtu, që sipas nenit 22 paragrafit 2 i Ligjit për dhënje në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së palujtshme të Komunës përcakton se Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta 6 mujore ti paraqes Kuvendit të Komunës edhe raportin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënjes në shfrytëzim.

z.Faik Ramadani: Përshëndetje. Jam ndërmjet asaj që tha Kryesuesi, që tha mundemi me i parashtrë kërkesat edhe pyetjet edhe me i marrë pastaj me shkrim. Meqenëse kjo ska ndodhë ende me u kthi një përgjigje siç duhet sepse kemi mbetur mbrapa me këtë pikë, mirë kishte me qenë mos me vazhduar me këtë piken pyetje-përgjigje, mirëpo ne po mbesim shumë komik para qytetarëve nese dikush ka bërë kërkesa. Është mirë me e gjetë një zgjidhje për këtë pikë.

z.Demokrat Mujota: Po mendoj më mirë me e shty këtë pikë ose me anulë, sepse nuk kemi prej kujt me marrë përgjigje sepse ekzekutivin nuk e kemi. Më mirë është me e mbyllë këtë temë me vazhdu me pikat tjera.

z.Haqif Arifi: Meqense ekzekutivi nuk është këtu deshta me ua bë një pyetje juve Kryesues e posaqërisht grupit parlamentar të LVV-së. Në seancën me datë 02.04.2026 janë marrë 8 vendime, në kuadër të atyre vendime 6 vendime janë votuar unanimisht edhe nga grupi parlamentar i LVV-së, ndërsa dy të cilat kanë qenë si lëshim teknik mundem me thënë, e jo shkelje procedurale ku nga një anëtarë i kuvendit janë propozuar dy pika të rendit të ditës që

pajtoj plotësisht me u rishqyrtuar edhe në bazë të rekomandimeve të MAPL-së. Mirëpo kjo pyetje shkon për grupin parlamentarë të LVV-së si nuk mundën me gjetë arsyen sepse edhe ata kanë votuar gjatë vendimeve unanimitet, as një votë kundër ska qenë si dhe kanë propozuar për me u larguar një pikë nga rendi i ditës që ka qenë edhe kërkesë e grupit parlamentar në mungesë të materialit që nuk ka ardhë në seancë me kohë.

z.Faik Ramadani: E kemi peticionin që e kanë bërë qytetarët për bizneset e Shtimes që e kalon trefishin e asaj për me shfuqizuar një vendim të mëhershëm për ndalimin e punës së në ditën e diellë, si dalim ne para qytetarëve kur ata e ka bërë peticionin edhe ne nuk mundëm hiq me propozuar në Kuvend. A do të bëjmë një pikë të veçantë apo si do të procedojmë këtë problem?

Pika 2

Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/64 të datës 02.04.2026, sipas rekomandimit të MAPL-së Nr.020-282/6 të datës 30.04.2026,

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Meqenëse nuk kemi Kuorum për të vazhduar me mbledhjen po e ndërprejmë mbledhjen në ora 10:55h. Vazhdojmë me mbledhjen në ora 11.09h. Konstatohet Kuorumi prej 11 anëtarëve prezent në mbledhje. Hapi diskutimin për këtë pikë. Meqenëse nuk ka diskutime po e hedhë në votim këtë pikë.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimitet vendosi të ANULOJË Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/64, të datës 02.04.2026, për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/17 të datës 31.01.2011, për Adresimin e Kërkesave të Qytetarëve, sipas rekomandimit të MAPL-së.**

Pika 3

Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/65 të datës 02.04.2026, sipas rekomandimit të MAPL-së Nr. 020-410/3 të datës 08.05.2026

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Hapi diskutimin për këtë pikë. Meqenëse nuk kemi diskutime, sipas rekomandimit të MAPL-së edhe ky vendim i Kuvendit duhet të shfuqizohet, po e hedhë në votim edhe pikën e tretë.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes unanimitet vendosi të ANULOJË Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/65, të datës 02.04.2026, për ndryshimin e nenit 6.9 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi-01/155 të datës 27.04.2023, sipas rekomandimit të MAPL-së.**

Pika 4

Shqyrtimi i Propozim - Vendimit për shfuqizimin e Vendimit Npi-01/17, të datës 31.01.2011 për adresimin e kërkesave,

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Të nderuar koleg këtë pikë e kemi shqyrtuar edhe në mbledhjet e kaluara, pra është një vendim i vitit 2011 i cili është marrë në atë kohë nga Kuvendi i Komunës, i cili adresimin e kërkesave e ka precizuar që të gjitha kërkesat të adresohen në drejtorin përkatës pastaj drejtoritë të i sjellin në Kuvend.

z.Demokrat Mujota: Nese është e nevojshme ne duhet ti ndjekim të gjitha procedurat sipas rekomandimit të MAPL-së, mirëpo duhet ta theksoj edhe një herë që kjo është domosdoshmëri e kërkesave të qytetarëve që kërkesat të vinë direkt në Kuvend, edhe besoj që kishte me qenë mirë që LVV-ja me qenë këtu me dhënë kontributin e vet mirëpo meqenëse ata nuk janë ne duhet të marrim një vendim që me dal me afat 15 ditë qysh është me dëgjime publike, dhe gjitha ato si i kanë rekomanduar edhe me u votu që kërkesat e qytetarëve me ardhë në Kuvendin Komunal në Shtime.

znj.Erza Salija: Edhe unë jam plotësisht pro që kërkesat të mos mbesin të mbyllura vetëm me një nivel, po të trajtohen edhe këtu në Kuvend. Mua personalisht nuk më duket as qasje e dëmshme as problematike, përkundrazi unë mendoj që do të ishte përmirësuar dukshëm trajtimi i kërkesave dhe shërbimi ndaj qytetarëve nese kërkesat do të vinin në Kuvend.

z.Haqif Arifi: Këtu po diskutojm për një ndryshim që nuk është teknik por në thelb është demokratik. Neni aktual parasheh që kërkesat e qytetarëve fillimisht të shkojnë në ekzekutiv, dhe pasi drejtoria përkatëse i vlerëson të kthehen në Kuvend. Kjo praktikë fatkeqësisht në shumë raste ka krijuar vonesa, mungesë të transparencës dhe mbi të gjitha një filter të pa nevojshëm për komunikim të drejtpërdrejt mes qytetarit dhe Kuvendit. Mirëpo nuk është e drejtë që një kërkesë e adresuar e qytetarit të ndalet dhe të filtrohet diku tjetër. Ky ndryshim është në shërbim të qytetarëve, është për një administratë më të hapur, më të drejtë dhe më efikase. Mendoj që me ndryshimin e këtij paragrafi të rregullores së punës rritet transpareca dhe shmangë filtrin e panevojshëm nga ekzekutivi, respekton vullnetin e palës në adresimin e kërkesave.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Atëherë po e hedh në votim pikën e katërt.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/17 të datës 31.01.2011, për Adresimin e Kërkesave të Qytetarëve.**

Pika5

Shqyrtimi i propozimit për iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës së Kuvendit Npi-01/155, të datës 27.04.2023,

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Meqë MAPL-ja e ka kthyer këtë vendim i cili nuk i ka përfillur sipas tyre procedurat, atëherë është mirë me u themeluar një komision prej 3, 5 apo 7 anëtarëve të Kuvendit.

z.Haqif Arifi: Unë mendoj që Komisioni me u formuar prej 5 anëtarve, 3 duhet të jenë prej secilit subjekt ndërsa 1 duhet të jetë prej ekzekutivit dhe 1 prej shoqëris civile.

z.Demokrat Mujota: Pajtohem me z.Haqif Arifin që Komisioni të jetë prej 5 anëtarve, që të kryhet kjo procedurë ligjore në afat prej 15 ditëve ashtu siç i kemi edhe rekomandimet prej MAPL-së, nga subjekti i partisë tonë propozojm z.Bajram Hajrizi.

z.Haqif Arifi: Nga subjekti i LDK-së, znj.Frosina Berisha-Ahmeti

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Nga subjekti i LVV-së z.Faruk Beqa, si dhe një përfaqësues nga ekzekutivi, dhe një përfaqësues nga shoqëria civile.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komitetve Npi-01/155 të datës 27.04.2023, në këtë përbërje:**

1. Bajram Hajrizi, përfaqësues nga PDK-ja,
2. Frosina Berisha-Ahmeti – përfaqësuese nga LDK-ja,
3. Faruk Beqa - përfaqësues nga LVV-ja,
4. _____ përfaqësues nga Ekzekutivi,
5. _____ përfaqësues nga Shoqëria Civile,

Pika6

Shqyrtimi i propozimit për iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së

Paluajtshme Komunale për periudhë më pak se një (1) vit, Npi-01/459 të datës 27.12.2023,

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Të nderuar koleg ju e keni pa një Rregullore Komunale e cila parasheh dhënjen në shfrytëzim të pronës komunale, mirëpo në këtë rast prona komunale mund të jap vetëm Kuvendi i Komunës sipas Ligjit për dhënje në shfrytëzim të pronave duke respektuar procedurën, ku Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit dhe në fund Kuvendi vendos se a i përket dhënjes së pronës në shfrytëzim.

z.Demokrat Mujota: Besoj që kjo është pika ku qytetarët duhet ta kuptojn që ekzekutivi komunal edhe Kryetari i Komunës është rasti eklatant, ku mirret në mënyrë të paligjshme dhënja në shfrytëzim e pronës publike në mënyrë eksplicite e Kuvendit Komunal. Andaj si e tillë ne duhet ta shfuqizojm këtë rregullore dhe autoritetin që i takon të ia kthejm Kuvendit Komunal.

znj.Erza Salija: Edhe unë mendoj që vendimet mbi pronën publike duhet të jenë vendime të Kuvendit dhe jo vendime të individëve, sepse prona publike është e qytetarëve nuk është e

individëve andaj mendoj që është shumë e rëndësishme vendimarrja kolektive në këtë proces në mënyrë që procesi të ketë transparenc dhe mos të ketë keqpërdorim të pronave.

z.Haqif Arifi: Ne sot po e diskutojm një rregullore që lidhet drejtpërdrejt me menaxhimin e pasurisë komunale, pra një pronë publike me qytetarët e Shtimes pikërisht për këtë arsye çdo dispozit e kësaj rregullore duhet të garantoj transparenc, llogaridhënje dhe kontroll institucional. Këtu kam vërejt se me nenin 9 dhe nenin 11 domosdoshmërisht duhet me bë ndryshime. Neni 9 këtu përjashtohet Kuvendi Komunal nga vendimarrja për dhënje ne shfrytëzim të pronës së palujshme për një vit, ne i dimë edhe qëllimet mirëpo pasuria komunale nuk është pronë e askujt dhe nuk mundet të trajtohet vetëm në nivel administrativ. Te neni 11 edhe këtu duhet të bëjmë ndryshime sepse këtu parashihet formimi i komisionit vlerësues prej 3 anëtarëve dhe gjithë me qenë sipas kësaj rregullore nga ekzekutivi. Unë kisha propozuar që komisioni të shkojë prej 5 anëtarëve, në këtë rast të shkojnë 2 anëtarë prej Kuvendit dhe 2 prej ekzekutivit dhe 1 prej shoqëris civile.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Pasi që jeni të pajtimit që komisioni të jetë në përbërje prej 5 anëtarëve. Vazhdoni ju lutem me propozimet e juaja.

z.Demokrat Mujota: Ne si grup parlamentar e propozojmë znj.Albana Podvorica – Hoxha.

z.Haqif Arifi: Nga rradhët e LDK-së propozojmë znj.Erza Salija.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Nga LVV-ja po e propozoj unë z.Besnik Seferin. Ndërsa pjesa e ekzekutivit me vendim të Kryetarit, si dhe pjesa e shoqërisë civile që do të sjellë procesverbalin për zgjedhjen e këtij, pas diskutimit dhe propozimit që ne do të i dërgojmë si Kuvend. Po i hedhë në votim emrat e propozuar.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për ndryshimin e Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim për më pak se një vit, Pronën e Paluajtshme Komunale, me numër: Npi-01/459 dt.27.12.2023, në këtë përbërje:**

1. Albana Podvorica - përfaqësuese nga PDK-ja,
2. Erza Salija - përfaqësuese nga LDK-ja,
3. Besnik Seferi - përfaqësues nga LVV-ja,
4. _____ përfaqësues nga Ekzekutivi,
5. _____ përfaqësues nga Shoqëria Civile.

Pika 7

Propozim – Vendim për formimin e Komisionit për verifikimin e gjendjes së pasurisë së banesave publike komunale në objektin “Fitorja” në Shtime

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Ne mundemi ta themelojm një komision i cili bazohet në nenin 12 shkronjës (d) dhe nenit 40 të shkronjës (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe në bazë të Statutit të Komunës, Kuvendi Komunal mund të themelojë komisione. Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Erza Salija: Unë personalisht e mbështes formimin e këtij Komisioni dhe mendoj që është i domosdoshëm për me u formuar, por gjithashtu theksoj që nuk mjafton vetëm formimi i tij në letër. Ky komision duhet të jetë menjëherë funksional dhe të filloj punën, në punën e këtij Komisioni duhet të mbizotëroj transparencja e plotë dhe raportimi i rregullt në mënyrë që qytetarët me u informuar qartë dhe saktë. Sepse për një kohë të gjatë ka munguar informimi, qartësia dhe transparencja për atë që ka ndodhë dhe si është menaxhuar ky proces.

z.Faik Ramadan: Pasi që e dimë që këtë propozim e ka sjellë në Kuvend Shefqeti, dhe pasi që mungon sot dhe unë e di që këtë punë e ka mision të tij, a do të ishte e mundur që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një senacë tjetër? Nuk jam “Kundër” unë jam absolutisht po në çdo fjalë që e ka fol Sheti, por pasi që nuk është këtu nëse ka mundësi e trajtojm në herën tjetër.

z.Demokrat Mujota: Besoj që nuk është e domosdoshme shtyerja e kësaj pike, por pasi jemi mbledhur për këtë temë ne mundemi me votuar. Dhe pas kontakteve me Shetin, ai është për me hyrë në këtë Komision. Ne si grup parlamentar e propozojmë z.Faik Ramadanin. Dhe propozojm që të jetë me 5 anëtarë ky Komision, 3 nga Kuvendi 1 nga Ekzekutivi dhe 1 nga Shoqëria Civile.

znj.Frosina Berisha - Ahmeti: Ne si grup parlamentar e propozojmë z.Shefqet Krasniqi.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Ma jepni edhe një propozim nga LVV-ja.

z.Demokrat Mujota: Nga LVV-ja e propozojm asambleistin e devotshëm dhe të përkushtuar z.Asllan Beqaj.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Propozimin nga ekzekutivi e sjellin me vendim të Kryetarit, si dhe shoqëria civile nga procesverbali i takimit që e mbajnë. Atëherë kush është "Për" që të formohet ky komision?

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për verifikimin e gjendjes së banesave kolektive te objekti 'Fitorja' në pronësi të Komunës së Shtimes në këtë përbërje:**

1. Faik Ramadani - përfaqësues nga PDK-ja,
2. Shefqet Krasniqi - përfaqësues nga LDK-ja,
3. Asllan Beqaj - përfaqësues nga LVV-ja,
4. _____ përfaqësues nga Ekzekutivi,
5. _____ përfaqësues nga Shoqëria Civile.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Pasi që diskutime tjera nuk ka mbledhjen e përfundoi në ora 11:35h.

Procesmbajtëse
Sadbere Halili





Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi

